

Semantic consumption as an unfathomed source of expressivity

Abstract: *The stylistic effects of semantic consumption in any literary text have to do with the growth of the creative and affective potency of the speech through the usage of more expressive lexical units rather than their synonyms, which are erased by the expressive effect. The mechanism of this phenomenon is implemented within a given text whenever the information provided is not only operative but also impressive. Semantic consumption implements two or more language elements. The element, which is considered semantically consumed, may appear along the discourse and it can be supplemented by a more expressive synonym reinforcement or, it may not appear at all in the text. They deviate depending on the literary-artistic awareness of the author. In their place emerge synonymous units which enjoy remarkable content and expression. Writer Ismail Kadare, for instance, is an expert in extracting the right term from the core of the language to further elaborate it.*

Keywords: *Phonetic linguistic consumption, contextual synonyms, symbolic sign, iconic sign, expression.*

Në ligjërim, sidomos në ligjërimin afektiv, shpesh lihen mënjatë fjalët e harxhuara kuptimisht, të konsumuara.

Konsumimi i fjalëve mund të ndodhë për shkaqe fonetike ose për shkaqe semantike.

Në shumë raste fjalëve shumë të shkurtra, u mungon shprehësia, ato, bile mund të zhduken krejt. Psh. Në asnjë gjuhë romane nuk mbijeton fjala e shkurtër latine **os** (gojë). Vetë latinishtja vulgare, për të ruajtur një numër fjalësh, i zgjaste ato me prapashtesa si **apis**, **auris**, **sol**. Me anë të tyre janë formuar fjalë, si **apicula**, **auriculus**..., **soliculus** (bletë, vesh, diell). Në këto raste prapashtesat nuk kanë vlerë diminutive, por përdoren për të rritur volumin e fjalës. Një dukuri e tillë vihet re dhe në gjuhën shqipe. P.sh.: Fjala **vezë** është e zgjeruar fonetikisht. Prapashtesa **-zë** nuk është afiks me vlerë diminutive, por përdoret për zgjerimin e vëllimit fonetik të fjalës **ve**.

Kur dy fjalë bëhen homonime (dmth përputhen fonetikisht) për shkak

të pësimeve fonetike që ndodhin në to, gjuha synon ta zhdukë homoniminë duke e zëvendësuar njërën fjalë me një fjalë tjetër. Fjala që zëvendësohet ndihet e konsumuar. Lidhur me zhdukjen e fjalëve për shkak të homonimisë e zëvendësimit e tyre me fjalë të tjera, Xh.Lloshi shkruan:

“Zhdukja e fjalëve është ndikimi më i fuqishëm e më karakteristik, që mund të ushtrojë homonimia në gjuhë dhe që shpie në ndryshime rrënjësore.

Emri gjedh-i për bagëtinë e trashë mendohet se mund të jetë zhdukur në toskërisht, sepse atje shqiptohet gjeth, e dilte homonim me gjeth-i, për gjethe.”¹

Një mendim të tillë shpreh edhe Jani Thomai kur trajton kundërveprimin e gjuhës ndaj homonimisë së padëshirueshme: „Një nga kundërveprimet e gjuhës për të shmangur homoniminë, që mund të sjellë keqkuptime e të errësorë ligjërimit, është rënia nga përdorimi i njërit homonim dhe zëvendësimi i tij me një fjalë sinonime me të.”²

Këto ishin rastet më kryesore të konsumimit fonetik të fjalëve: konsumimi për shkak të vëllimit të vogël fonetik e të përputhjes fonetike të fjalëve.

Konsumimi semantik lidhet me dendurinë e përdorimit të një fjale. Përdorimi i shpeshtë e harxhon fjalën kuptimisht. Duke vënë në dukje veprimin konsumues të kohës e të shtrirjes në përdorim në rastin e fjalës *zemërgur* Androkli Kostallari shkruan:

“Mbiemri *zemërgur* është mbiemër cilësor me prejardhje popullore, që përdoret prej kohësh edhe në gjuhën e shkruar dhe që nga pikëpamja stilistike është bërë një fjalë neutrale.”³

Më e prekshme nga harxhimi kuptimor është ajo pjesë e përmbajtjes së fjalës që përbën atmosferën afektive, si ngjyrimet emocionale, vlerësuese-subjektive etj. Vlora ekspresive e fjalëve dobësohet nga përdorimi. Fjalët që shprehin emocione, gjendje shpirtërore, vlerësime subjektive, dhe ato më të fortat e më ekspresivet e humbasin forcën, kur përsëriten shpesh.

Dukuria e konsumimit semantik është trajtuar dhe në letërsinë botërore. Psh. Vandrie në veprën „Le language“ në kapitullin „Comment les notions changent de noms“ shkruan për harxhimin kuptimor të fjalëve. Këtë dukuri e trajton teorikisht e të ilustruar me shembuj nga gjuhë të ndryshme. Ja si shkruan Vandrie në një fragment të kapitullit:

“Fjala *beaucoup* e gjuhës frënge ka zëvendësuar fjalën e vjetër *moult*

1 XH. LLOSHI, *Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonisë në gjuhën shqipe*, Studime mbi leksikun e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, 1972, fq. 228.

2 J. THOMAI, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, 1972.

3 A. KOSTALLARI, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve, 1972, f. 130.

nga multum (latinisht). Në gjuhën e përditshme përdoren dhe mjete të tjera me këtë vlerë:

një numër i madh, një tufë, një sasi, turma, vala etj. Në gjuhët ku sipërorja nuk shënohet me sufiks të specializuar, por me bashkimin e një ndajfoljeje me mbiemrin, ndajfolja del në disa variante...Ne kemi në frëngjisht ndajfoljen **trés** që i përgjigjet **trans** të latinishtes (tej për tej)...

Por **trés** sot është bërë banale dhe e ka humbur forcën. Për të dhënë një sipërore me vlerë të plotë fjala **trés** nuk na mjafton, për këtë përdoren ndajfolje, **si parfaitement, complètement, absolument, tout á fait** etj. (përsosurisht, krejtësisht, absolutisht, krejt).

Të tilla ndajfolje ka me shumicë në frëngjisht...Kjo gjë nuk ndodh vetëm në frëngjisht. Në gjermanishten familiare thuhet për një grua **furchtbar nett** (tmerrësisht xhentile), **fuchtbar süß** (tmerrësisht e ëmbël), **hübsch gesund** (shëndoshë e mirë)...

Vlera e fjalëve **furchtbar, hübsch** lidhet me vendin e tyre dhe me faktin që ato nuk ndahen nga mbiemri që i ndjek, me të cilin përbëjnë një unitet mendor. Është fjala këtu për krijimin e një morpheme, por të një morpheme shprehëse. Të gjitha fjalët që janë pak a shumë ekspresive janë të ekspozuara ndaj dobësimit të vlerës së tyre, gjë që sjell zëvendësimin e tyre."⁴

Konsumimi semantik që ndihet sidomos në fjalët me vlera shprehëse është shumë veprues në letërsinë artistike ku shprehësia është një atribut i përhershëm i leksikut. Vetë konsumimi është një mënyrë për të arritur një shprehësi sa më të lartë.

Në letërsinë artistike kjo mënyrë fiton një rëndësi të veçantë, ka një përhapje të madhe e që bie në sy. Prosedea e konsumimit semantik në letërsinë artistike kushtëzohet dhe nga mënyra e paraqitjes së materialit letrar e nga mënyra e komunikimit me lexuesin. Këto dy momentet e fundit paraqitja e materialit letrar dhe forma e komunikimit me lexuesin kanë sjellë një përdorim të dushëm të këtij mekanizmi në prozën e I.Kadaresë. Leksiku i Kadaresë përmban një rreth të gjerë njësisht shprehëse e shumë shprehëse, që kanë arritur nivelin e lartë shprehësor, duke u përfshirë në prosedenë e konsumimit. Ky është një konsumim i llojit stilistik që ndryshon nga konsumimi i zakonshëm linguistik nga shpejtësia e veprimit e nga përhapja. Në konsumimin stilistik fjala harxhohet e zbehet aty për aty e nuk del më në kontekstin ligjërimit, ia le vendin një tjetre, përgjegjëse më shprehëse (kur rasti e kërkon që ajo të rishfaqet). Në fakt, konsumimi stilistik kushtëzohet në një shkallë të madhe nga interesat e prirjet stilistike të shkrimtarit, nga ndieshmëria e tij ndaj forcës emocionale-vepruese të fjalës. Është vetë shkrimtari, që e ndien të harxhuar një fjalë, pa efekt, dhe ndërmerr zëvendësimin a plotësimin e saj.

4 J. VENDRYES, *Le language*, Paris, 1912.

Zbehja kuptimore, rifitimi i shprehësisë me një mjet tjetër sinonim nuk janë thjesht veprime formale me gjuhën, veprime në plan gjuhësor me efekte të momentit e që lënë pas boshllëk dhe asgjë. Por gjithmonë gjuha ndjek relievën e mendimit. Është konceptimi artistik i shkrimtarit që e vë në punë mekanizimin e harxhimit semantik.

Për të vepruar e ndikuar sa më me forcë në mendimin e në ndjenjën e lexuesit, në aftësitë e tij kapëse e perceptuese shkrimtari shpesh i ekzagjeron mendimet, bën intensifikimin e mendimit. Mendimi i intensifikuar shprehet vetëm me mjete gjuhësore me vlera ndikuese, me shprehësi të spikatur. Edhe në këtë rast lihen mënjanë njësitë “më të qeta” e pa ndikim dhe veprohet me njësi që e trazojnë përfytyrimin e vëmndjen e lexuesit.

Konsumimi semantik krahas përftesave të tjera ndihmon që të arrihet shprehësia e kërkuar.

Le të merremi tani me vetë prosedenë e konsumimit semnatik me gjymtyrët që angazhon kjo prosede e më mekanizmin e veprimit të saj.

Konsumimi semantik ndodh, vihet re, brenda një konteksti a brenda një thënieje. Kjo përftesë ka të bëjë me dy fjalë (rrallë me më shumë se dy fjalë). Njëra prej tyre, ajo me forcë shprehëse të harxhuar zëvendësohet me një tjetër që është më shprehëse. Midis dy fjalëve që marrin pjesë në konsumimin ka sinonimi, kryesisht jo të plotë, përgjithësisht-kontekstuale. Fjala e harxhuar mund të jetë e pranishme në tekst ose jo. Ajo mund të ndihet e konsumuar që në ndërgjegjen e shkrimtarit dhe ai nuk e sjell këtë fjalë në ligjërim, por sjell një tjetër, më domethënëse.

Sic u tha, në procesin e harxhimit semantik-emocional përfshihen një rreth i gjerë fjalësh. Me një ndarje të përgjithshme në këtë rreth fjalësh dallohen këto grupe:

1. Fjalë ekspresive (me ngjyrimë emocionale, të figurshme, të ligjërimit afektiv etj.)

2. Fjalë të tjera, pa ndonjë ekspresivitet të dukshëm, por që përdoren shpesh, shumë shpesh e që sjellin monotoni në ligjërim (për këtë zëvendësohen).

3. Harxhimi kuptimor në disa raste ndodh për arsye shoqërore. Në emër të një etike, të një shijeje të ngritur, të një parapëlqimi të përparuar e të përgjithshëm zgjidhen disa fjalë në vend të disa të tjerave që kanë përmbajtje të rëndë.

I

Në këtë grup përfshihen këto nëngrupe.

1. Fjalë që shënojnë tipare cilësore a rethanoresh si: **shumë, pak, i madh, i vogël, i bukur, i mirë, larg, i vjetër**.

2. Fjalë që shënojnë veprime a gjendje

3. Fjalë që shënojnë sende a dukuri

Në nëngrupin e parë, procesit të konsumimit, i nënshtrohet gjerësisht fjala **shumë**. Nga përdorimi i madh ajo e ka zbehur aftësinë për të shprehur sasi të mëdha e të spikatura. Në tërë kuptimet e saj (3 kuptime sipas FGJSH) ajo ka pësuar një harxhim të tillë që ka sjellë zëvendësimin e saj në shumë raste.

Nga ana tjetër ajo përdoret aq shumë në ligjërime (gjë që lidhet me kuptimin e saj), sa do të ishte e pakëndëshme të shfaqej e të rishfaqej herë pas here në tekste e situata të ndryshme.

Për të shënuar sasi të mëdha qeniesh, sendesh a dukurish (kuptimi i parë i fjalës shumë) shkrimtari e përdor rrallë, shumë rrallë këtë fjalë. Në ligjërimin artistik, plot ngjyra dhe efekte, nuk është me vend përdorimi i dendur i së njëjtës fjalë. Me vlerën e saj përdoren mjete të tjera, si emra që shënojnë sasi në kuptimin e tyre të figurshëm. Duke qenë se përdoren në kuptimin e figurshëm këto fjalë shprehin ngjyime emocionale. Bashkë me sasinë ato shprehin dhe qëndrime të ligjëruetit. Edhe sasinë ato e shprehin me tepëri e bollëk. P.sh.:

I drejtohej një ditë me vete pas një **breshëri** fyerjesh që kishin këmbyer në koridor (Koha, 17);

Serbët na kanë borxh **lumenj** gjaku. (Koha, 203);

Fuqitë e mëdha po shqyrtonin një **turmë** të tërë princërish. (Koha, 320);

I lëshuan nga sipër një **re** shigjetash. (Kështjella, 229);

Kemi një **atdhe** me këta të mjerë. (Gjenerali, 25);

Një **univers** fatkeqësish (Ura, III);

Gjithë ato net... kishin qenë për ta një **vargan** orësh torturuese. (Ura, 185);

Mos vallë për këtë derdhën **oqeane** gjaku brezat osmane. (Ura, 205);

E merr dot me mend gjithë këtë **oqean** njerëzish. (Dimri, 125);

Filloi të hidhte **male** balte mbi të posavarrosurin. (Dimri, 492)

Për të shprehur sasi realiesh përdoren edhe numërorë që shënojnë sasi të papërcaktuara, por të mëdha. P.sh.:

Cili vend në shekullin tonë ka nxjerrë kaq **mijëra** Brutër? (Koha, 328);

Ja ku ishin me **mijëra**, me **dhjetëra mijëra**, njëra pas tjetër. (Koha, 262);

U dëgjua... zhurma e **qindra** hapave. (Kështjella, 73);

U rrahën **dhjetëra** variante. (Kështjella, 85);

Le të bëhej fli për hir të **mijëra e mijëra** kalimtarëve. (Ura, 79).

Për të treguar masën e shkallën e veprimit a të gjendjes shkrimtari zgjedh fjalë që e paraqesin veprimin a gjendjen e shprehur nga folja me një intensitet të veçantë. P.sh.:

Rozmaria quhej... më donte **kiamet**. (Koha, 89);

S'pushonin së ankuari se mërzhiteshin për **vdekje**. (Koha, 329);

Prindërit u plakën **sa për një shekull**. (Ura, 88);

Iu qartësua befaz **gjër në tmerr**. (Ura, 224)

Na kanë vrarë **kiamet**. (Gjenerali, 27)

Atij i pëlqente Suzi **tek s'bëhet**. (Emblema, 115)

Atë natë ata urreheshin **për vdekje**. (Dimri, 280)

Fjalët e shprehjet: **kiamet, për vdekje, sa për një shekull, gjer në tmerr, tek s'bëhet**, krahas kuptimit nocionor të fjalës **shumë** shprehin dhe emocione, qëndrime subjektive, ekzagjerime sugestionuese. Në rastet e përmendura ato mund të zëvendësoheshin me fjalën **shumë** por thëniet do të humbisnin tepër në shprehësi. Midis fjalës shumë dhe fjalëve të nënvizuara në thëniet e cituara ka sinonimi tepër të pjesshme, sinonimi kontekstuale.

Si fjalë shkalle njësia **shumë** njeh harxhimin më të madh semantik. Ajo përgjithësisht nuk përdoret për të shprehur shkallën më të lartë të tiparit. Kjo shkallë jepet me ndihmën e fjalëve të tjera.

Të tilla fjalë janë:

a) Tepër, mjaft: Nuk mund të thuhet që këto fjalë kanë forcë shprehëse më të madhe se

fjala **shumë**. Por meqë përdoren më rrallë në ligjërimin e zakonshëm, ato nuk e kanë ndier veprimin konsumues të kohës. P.sh.:

Ato ishin vise që perandoria i kishte pushtuar **tepër** vonë. (Koha, 129);

Duhej të ishin **mjaft** larg. (Koha, 291); Mendja e tij ishte **tepër** e lodhur. (Koha, 125);

Ajo ishte **tepër** e lartë. (Kronikë, 20);

Qielli ishte **tepër** i pakuptueshëm. (Kronikë, 71);

Jam **tepër** plakë për ëndërrime të tilla. (Dimri, 100);

Sytë e tij... ishin **mjaft** të shtrembër. (Dimri, 121);

Ishte një burrë i shëndoshë, **mjaft** serioz. (Dimri, 213);

Ajo që kishte ndodhur duhej të ishte **tepër** interesante. (Dimri, 295);

Është një gjë **tepër** e rëndë. (Dimri, 299);

Korridoret iu dukën **mjaft** të zhurmshme. (Dimri, 346);

Goditja ishte **tepër** e befasishme. (Dimri, 358);

Ishte një pakënaqësi **tepër** e mjegullt. (Dimri, 387);

Koha kishte qenë **tepër** e dendur. (Dimri, 407);

Inxhinieri dukej **mjaft** i pezmatuar. (Dimri, 480);

Unë isha **mjaft** i qetë. (Emblema, 32);

Shahu ishte me kostum të zi, **tepër** elegant. (Emblema, 72);

Ishte **mjaft** e pikëlluar. (Emblema, 79);

Ai u tregua **tepër** i gatshëm. (Emblema, 74);

b) Tejet, jashtëzakonisht

E japin tiparin në përmasa jo të zakonshme. Në semantikën e këtyre fjalëve si fjalë shkalle spikat ideja e kapërcimit të një kufiri, prandaj të përdorura si të tilla ato ia kalojnë në shprehësi fjalës **shumë**. P.sh.:

Ngjante e varfër dhe **tejet** e pikëlluar. (Koha, 169);
 Të dy me fytyra **tejet** serioze... (Koha, 343)
 ...Me trupin e tij **jashtëzakonisht** të hollë e të hallakatur ... (Koha, 226);
 Ishte **jashtëzakonisht** e lodhur. (Dimri, 177);
 Ishte një shi **jashtëzakonisht** monoton. (Dimri, 391)
 Atë natë ishte **jashtëzakonisht** i ndezur. (Dimri, 428);
 Me një çantë **jashtëzakonisht_jashtëzakonisht_** të madhe... (Dimri, 110);

Fjalëve të shkallës **tejet** e **jashtëzakonisht** mund t'u shtojmë **jashtë mase** që del me po atë vlerë leksikore. Ndërsa në përmbledhjen “Koha e shkrimeve” përdoret më tepër fjala **tejet**, në veprat e mëparshme, si “Dimri i madh”, “Emblema e dikurshme” etj., fjala **tejet** nuk para takohet, ndërsa togu **jashtë mase** përdoret, pothuaj, dendur.

P.sh.:

I ngjante një peri të holluar **jashtë mase**. (Ura, 147);
 Strehë të kërcyera **jashtë mase**... (Kronikë, 95);
 ...të zbardhur **jashtë mase** ... (Dimri, 67);
 Ishte zemëruar **jashtë mase**. (Dimri, 40);
 Sytë e Viktorit ishin hapur **jashtë mase**. (Dimri, 341);

c) Fjalët **krejtësisht**, **krejt**, **fare** përdoren për të dhënë tipare në një shkallë të skajshme.

P.sh.: Ajo kokë me flokë të verdhë ishte **krejt** e largët për të. (Koha, 261);
 Po trokiste **fare** ultazi. (Koha, 261); Nga struktura janë **krejtësisht** të largëta. (Koha, 387).

Fjalët e nënvizuara janë sinonime me fjalën **shumë** jo në tërësi përmbajtjen e tyre kuptimore, por vetëm në përdorimin e tyre si fjalë shkalle, në kuptimin e dytë sipas FGJSH (1980). Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (1980) fjala **krejt** shpjegohet kështu:

- 1) Plotësisht fare, tërësisht
- 2) Shënon shkallë të lartë të një tipari cilësor, fare.

Fjala **krejtësisht** ka të njëjtën strukturë kuptimore. Kështu fjalët **krejt**, **fare**, **krejtësisht** japin një shkallë të lartë tipari, gjë që shpjegohet me kuptimin e tyre që ka në bazë nocionin e shterueshmërisë. Ja dhe disa shembuj të tjerë:

Çadra e Tursun pashait ishte **krejt** e errët. (Kështjella, 177);
 Dukej një pjesë e oborrit të brendshëm **krejt** e shkretë. (Kështjella, 190);
 Një fjalë e re, **krejtësisht** e panjohur. .. (Kronikë, 51);
 Ishte tani **fare** pranë. (Kronikë, 20);
 Ai qe **fare** i ri. (Gjenerali, 184);

Emri i tij m'u duk **fare** i shpëlarë. (Ura, 419);
 Ia thashë këtë mendim **fare** hapur. (Ura, 423); Ti je krejt I nxehtë (Ura, 510);
 Kurse ajo, **fare** e qetë, rrinte me kokën mënjanuar. (Dimri, 49);
Krejtësisht i dërrmuar, ai u shkëput herën e tretë nga koka. (Ura, 179);
 Kishin folur me njëri-tjetrin **fare** thjesht. (Dimri, 49);
 Mendja e Rabos ishte **krejtësisht** e mpirë. (Dimri, 70);
 Pyeti ajo me zë **fare** të ulët. (Dimri, 201);
 Ecte **fare** ngadalë. (Dimri, 245);
 Ishte një si trokitje e dobët, **fare** e lehtë. (Dimri, 245);
 Një aviator i ri, **krejt** i ngjashëm me Maksin. (Dimri, 272);
 Gjyshja qe plakur **fare**. (Dimri, 313)
 Kjo ishte një gjë **fare** e thjeshtë. (Dimri, 339);
 Fshati ishte **fare** i vogël. (Dimri, 468);
 Pyeti tjetri **fare** befasisht. (Dimri, 482);
 Ishte **krejt** e zbehtë. (Dimri, 488);
 Ishte **krejt** i hutuar. (Dimri, 503);
 Vështonte **fare** pranë. (Dimri, 549);
 Ai e mbante mend **fare** mirë. (Dimri, 571);
 E gjithë kjo kishte qenë... **fare** e thjeshtë. (Dimri, 614);
 Ky ishte një qytet **fare** i vogël. (Emblema, 48);
 Fytyra **krejtësisht** serioze... (Emblema, 191);
 Një plak **fare** i imët. (Emblema, 210);
 Ishte bërë **krejt** e kuqe. (Emblema, 222);
 Në rrethana **krejtësisht** misterioze. (Emblema, 223);
 Ana ishte **krejt** e zbehtë. (Emblema, 225);
Krejt e përpirë nga ekrani... (Emblema, 82);
 Zëri iu duk **krejtësisht** i huaj. (Emblema, 121);
 Me zë **fare** të ulët... (Emblema, 125);
 Ishte **krejt** e verdhë. (Emblema, 126)

Si fjalë shkalle përdoren dhe një grup fjalësh që në kuptimin e tyre të mirëfilltë shënojnë sende me veçori të spikatur. Këto fjalë e japin tiparin në nivele maksimale e në mënyrë mbresëlënëse. Në këtë grup përfshihen fjalët: **plumb, akull, flakë, helm, yll, dyllë, qull, katran, gjak, kallkan, hekur** etj. Psh.

Hero bëhej njeriu më Çeçilje Tuzin që ishte e bukur **yll**. (Koha, 50);
 Gojën e kishte të hidhur **helm**. (Koha, 70);
 U bë **flakë** e kuqe. (Koha, 147);
 Kokën e kishte... të rëndë **plumb**. (Koha, 250);
 Tjetri u bë **flakë** i kuq. (Kështjella, 91);
 Ai ishte bërë **dyll** i verdhë. (Kronikë, 35);

Iku e lagur **qull**. (Gjenerali, 198);
 Binte një shi i vjetër, i rëndë **hekur**. (Gjenerali, 60);
 ...Fuçi të zeza **katran** ... (Ura, 100);
 Sytë dhe sidomos qafën i kishte **gjak** të kuqe. (Ura, 329);
 Tjetri, **dyllë** i verdhë, mundohej të shpjegohej. (Dimri, 36);
 Balli i rënduar **plumb** nga pagjumësia... (Dimri, 181);
 Piruni e thika iu dukën Zanës të rënda **plumb**. (Dimri, 210);
 Gjithçka, pjatat, lugët u bënë të ftohta **akull**. (Dimri, 309);
 Ishin ca net të ftohta **kallkan**. (Dimri, 309);
 Kurse ajo, masa e rëndë **plumb**. (Dimri, 394);
 Qafa i qe bërë **flakë** e kuqe. (Dimri, 457);
 Pranvera qe e ftohtë **kallkan**. (Emblema, 145)

Këto fjalë janë të gjitha me bazë popullore, përdoren rregullisht në gjuhën e gjallë të përditshme. Kadareja e përdor mjeshtërisht dhe gjerësisht këtë fond. Një pjesë e mjeteve që përdor Kadareja për të ndërtuar shkallën sipërore (të mbiemrave e të ndajfoljeve) janë tashmë të njohura, të përshkruara e të rekomanduara nga gramatika normative e gjuhës shqipe. Por, këto mjete, të evidentuara në gramatikat, rrallë përdoren nga shkrimtarë të tjerë në atë sasi, larmi e shprehësi si te Kadareja. Numri i mjeteve të tilla shtohet me të tjera, disa prej të cilave përshkruhen në Gramatikë⁵, ndërsa disa të tjera përbëjnë një fond original shkalle. Në paragrafin „Shkalla sipërore“ (e mbiemrit) të „Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe“ shkruhet: „Si ndajfolje të tilla (për të ndërtuar shkallën sipërore) përdoren dhe disa ndajfolje të tjera përforcuese, si: **thellësisht**, **tmerrësisht**, **çuditërisht**.⁶

Kadareja i përdor herë pas here këto fjalë që shprehin njëherazi shkallë të lartë tipari dhe ndjenja të ndryshme, si çudi, befasi etj.

Rugët ishin **çuditërisht** të shkreta. (Kronikë, 170);
 Vera kaloi **çuditërisht** shpejt. (Ura, 92);
 Qenë bërë **çuditërisht** të lodhur. (Ura, 333);
 Ndihesha **çuditërisht** i lehtësuar. (Ura, 270);
 E ngjashme **çuditërisht** me zinë e ballkanasve... (Dimri, 186);
 Me një spanjishte të ngjashme **çuditërisht** me një fëshfërimë fshese. (Dimri, 194);
 Duart e tij të holla, **çuditërisht** të pasigurta... (Dimri, 306);
 Zëri i saj ishte **çuditërisht** i ngrohtë. (Dimri, 360);
 Rënkimi i erës u dëgjua **çuditërisht** pranë. (Dimri, 159);
 Koha e kalimit të urës i dukej... **tmerrësisht** e gjatë. (Ura, 167)
 Në mënyrë origjinale për të shprehur intensitet tipari me anë të

5 Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 177.

6 Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 177.

shkallës sipërore, shkrimtari përdor ndërtime ku si fjalë shkalle shërben një element që, rregullisht, nuk e kryen këtë funksion. P.sh.:

Grindjet... kanë qenë **dëshpërimisht** të shpeshta. (Ura, 34)

Fjala **dëshpërimisht** tërheq vëmendjen me ngarkesën e saj të madhe kuptimore-emocionale. Ajo përdoret për të shënuar dhe shprehur kohëzgatje (sasi), vlerësim emocional negativ dhe mbi të gjitha një ide të re, si neologjizëm që është.

Ose: Gjyqi... do të ishte, me sa duket, **dëshpërimisht** i gjatë. (Ura, 118)

Rumuni buzëqeshi **gjerësisht** i lehtësuar. (Dimri, 53)

Thirri ai me një zë të trashë **solemnisht** ogurzi. (Dimri, 463)

Çdo gjë ishte vërtet banale dhe **varfërisht** e frikshme. (Emblema, 364)

Disa ndërtime para-fjalë + emër janë një mjet tjetër për formimin e shkallës sipërore që shpreh tipare të zmadhuara dhe emocionuese. P.sh.:

Shkëlqeu befas, i largët **gjer në dhimbje**, alumini i tij i shndritshëm. (Kronikë, 107)

Do të të martojë nëna me ndonjë çupë të bukur **për merak**. (Gjenerali, 106);

Hëna e yjet s'janë gjë tjetër, veçse lloje emblemash...një gjë shterpë, shterpë **gjer në llahtarë**. (Ura, 226);

Kjo është një gjuhë e varfër **në kulm**. (Ura, 270);

Të bardhë **gjer në lodhje**... (Ura, 428);

Uniteti i plotë, **gjer në mërzi**... (Dimri, 190);

Treni ikte midis atij lëmimi stepe të njëtrajtshme **gjer në çmenduri**. (Dimri, 416);

Lidhja e tyre do të ishte e gjatë, deri **në pambarim**. (Emblema, 255)

Fjalët e nënvizuara shënojnë shkallë të lartë tipari dhe shprehin , njëkohësisht, emocione që rrjedhin nga ky tipar i perceptuar në mënyrë të zmadhuar. Mjetet gjuhësore të zgjedhura për këto raste ia përçojnë gjithçka lexuesit: idetë, emocionet, vlerësimet subjektivë, zmadhimin.

Së fundmi, shkalla e lartë e tiparit jepet dhe me anë të përdorimit të shprehjeve dy a më shumëfjalëshe përbri fjalës që shënon vetë tiparin ose me një fjali të tërë:

Presidiumi zuri vend i vjetër **si nga epoka e gurit**. (Koha, 265);

Ajo mbrëmje iu duk e largët **si nga një botë tjetër**. (Kështjella, 221);

Tingulli i goditjes së kamzës tani vinte i thellë si **nga fundi i dheut**. (Gjenerali, 10);

Xhadeja ishte e moçme sa **s'mbahej mend**. (Ura, 20);

...I mënjauar **si nga ana tjetër e jetës**... (Ura, 59);

Gjithçka ishte e largët, si nga një **botë tjetër**. (Dimri, 276);

Kështjella mesjetare e Kremlinit e vjetër **sa bota**. (Dimri, 308);

Të largëta **si nga një kohë vjetër**. (Dimri, 426)

Formulimet: *si nga epoka e gurit, si nga një botë tjetër, si nga fundi i dheut, sa s'mbahej mend, si nga ana tjetër e jetës* etj. janë sinonime me fjalën **shumë** në përdorimet e mësipërme. Fjala **shumë** mund t'i zëvendësojë ato në rastet e cituara. Sinonimia është kontekstuale. Por, formulimet disafjalëshe janë më ekspresive nga fjala **shumë** se kanë vëllim më të madh fonetik e kuptimor si dhe karakter të figurshëm. Për të ilustruar mendimin që fjala **shumë**, si fjalë shkalle, përdoret pak, po japim disa shifra. Në tregimin „Sjellësi i fatkeqësisë“ (Koha e shkrimeve) në 21 përdorime fjalësh shkalle vetëm pesë herë del fjala **shumë**. Në 16 përdorimet e tjera dalin fjalët: **tepër, fare, plumb, flakë, çuditërisht, mijëra** etj.

Në tegimin „Përçmimi“ (Koha e shkrimeve) fjala **shumë** përdoret vetëm pesë herë, ndërsa fjalë të tjera me të njëjtën vlerë, si **tepër, helm, breshëri** etj, përdoren dy herë më shumë.

Fjalët që shënojnë tipare cilësore e kanë në natyrën e tyre shprehësinë. Duke cilësuar e karakterizuar, ligjëruesi shpreh dhe vlerësime e qëndrime për atë që cilësohet. Gjatë përdorimit ndodh që këto fjalë e harxhojnë shprehësinë. Prandaj ato zëvendësohen me fjalë të tjera më shprehëse.

Fjala **i madh** nga përdorimi i gjatë dhe i dendur është çngjyrosur dhe neutralizuar. Forca e saj shprehëse është dobësuar. Për të dhënë nocionin, që shpreh ajo, shkrimtari zgjedh fjalë të tjera. Këto fjalë ose shprehin madhësi që fjala **i madh** e vetme nuk arrin t'i japë në përmasat e tyre, ose e shprehin madhësinë në mënyrë më ekspresive dhe ndikuese. P.sh.:

Bakllavaja **kolosale** e banketit të festës së Manastirit... (Koha, 345)

...Urimet apo mallkimet me përmasa **kozmike**... (Koha, 391)

... Duhej një faktor **titanik**. (Koha, 377)

Fjalët **kolosale, kozmike, titanik** e kanë në themel të kuptimit të tyre idenë e madhësisë, të një madhësie pa cak. Kuptimi i tyre i parë dhe kryesor është **shumë i madh** (sipas FGJSH, 1980). Bashkë me këtë ide ato shprehin dhe emocione që lindin nga paraqitja e zmadhuar e diçkaje, si befasi (dritare kolosale), çudi (baklava kolosale) etj.

Fjala **kozmike** shpreh madhësi në kuptimin e saj të figurshëm.

Me vlerën e fjalës **i madh**, sinonime me të në kuptimin e tyre të figurshëm, paraqiten një rreth fjalësh që bien në sy me fuqinë e tyre shprehëse e ndikuese. Të tilla janë fjalët e nënvizuara në shembujt e mëposhtëm:

Pas gjysmë ore mundimi **të skëterrshëm**... (Koha, 22);

Ndjeu një lodhje **vdekjeje** në të gjitha gjymtyrët. (Koha);

Topat i kishin grykat e irrituara, me një gjatësi **të përbindëshme**. (Dimri, 514);

Ata viganë me gjatësi **të pallogaritshme**... (Dimri, 508);

Po zbrazej me një shpejtësi **të habitshme**. (Dimri, 18);

E shpërdarë në përmasat e pamata të një **universi** malli... (Dimri, 570);

Shfaqur me një qartësi **të padurueshme**... (Dimri, 567);
 Shumat e shënuara në letër ishin **prrrallore**..(Ura, 14);
 Ju s'do të kuptoni dot kurrë se ç'profesion **titanik** është ky. (Ura, 240);
 Kjo ishte një punë me përmasa **dëshpëruese**. (Ura, 255);
 Më rritjen në përmasa **të frikshme** të aparatit burokratik... (Ura, 260);
 Me një shpejtësi **katastrofike**... (Ura, 364);
 Nriçimi i një qielli të larguar në lartësitë **marramendëse**... (Dimri, 43);
 Ka një dhembje **universale**. (Ura, 376);
 Ndieja një dëshirë **të papapërballueshme** për të folur me dikë. (Ura, 399);
 Shushurima e K., e rritur në përmasa **të frikshme** nga mikrofonët... (Ura, 472);
 Në verandë u bë një heshtje **vdekjeje**. (Ura, 68);
 Dendësia e mendimeve ishte **e padurueshme**. (Dimri, 195)
 Midis shtëpive me lartësi **të padurueshme**. (Kronik, 25);
 Pusi i dritës u dendësua me një herë dhe me një qartësi **mizore** filloi të rrëshqiste. (Kronikë, 71);
 Qyteti me një qartësi **mizore**; Pothuaj vertikal. (Kronikë, 226);
 Pastaj ia dha një zhurmë **skëterre**. (Kështjella, 51);
 Me një shpejtësi **të pabesueshme** vendosin shkallët. (Kështjella, 60);
 Gjithë asaj tendosjeje nervash papritur ia zuri vendin një plogështi **vdekjeje**. (Kështjella, 70);
 Duke bërë një përpjekje **mbinjerëzore**... (Kështjella, 105);
 Pastaj u bë një qetësi **vdekjeje**. (Kështjella, 12);
 Në fytyrat dhe në lëvizjet e tyre dukej një lodhje **e llahtarshme**. (Kështjella, 196);
 Hija e tij në tokë kishte një gjatësi **të përbindshme**. (Kështjella, 200);
 Po vinte mëngjesi me saktësinë e tij **mizore**. (Kështjella, 201);
 Trajtë me një lëmimi **të përbindshëm**... (Emblema, 70);
 Ishin përllogaritur me një saktësi **të frikshme**. (Emblema, 190)
 Fjalët e nënvizuara, që shënojnë nocione dhe shprehin emocione të gjithëfarshme, e japin tiparin e madhësisë në përmasa e me afeksione jo të zakonshme. Shpesh herë këto fjalë nuk shënojnë vetë tiparin (idenë e zmadhuar mbi këtë tipar), por efektin që prodhon një tipar i tillë, pasojën që rrjedh nga kontakti me realien që ka të bëjë me madhësinë e diçkaje dhe shënohet me kuptimin e figurshëm të fjalës. Fjala, në fakt, shpreh drejtpërsëdrejti emocionin që prodhohet kur gjendesh përballë tipareve që kanë të bëjnë me madhësinë e pazakonshme të realieve. P.sh.: Punë me përmasa **dëshpëruese** ... (kaq e madhe sa të dëshpëron)
 Rritjen me përmasa **të frikshme** ...(rritje kaq e madhe sa të tremb)
 Me një shpejtësi **katastrofike** ... (kaq të madhe sa mund të sjellë katastrofë)

Dukej një lodhje **e llahtarshme** ... (një lodhje e madhe që shkakton llahtarë)

Me një shpejtësi **të pabesueshme** ... (e madhe sa s'të besohet)

Zmadhimet nga një herë janë të skajshme dhe efekti tek lexuesi është maksimal:

Një plogështi **vdekjeje**; një zhurmë **skëterre**; një qartësi **mizore**; gjatësi **e përbindshme**; heshtje **vdekjeje**.

Për një dukuri të tillë Xh.Lloshi në "Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe" shkruan :

"Shprehja emocionale-vlerësuese e rrit intesitetin e thënies, zbehet kuptimi sendor e nocionor dhe dalin në rrafshin e parë përbërësit semantikë, që i shërbejnë përforcimit" (f.154)

Ideja e madhësisë (si tipar) shprehet dhe me fjalë që në kuptimin e tyre të mirëfilltë e kryesor shënojnë madhësi pa cak. Ideja, kështu, jepet e zmadhuar dhe e rrethuar me ngjyime emocionale të shkaktuara nga imagjinimi i së pakufishmes. Psh.:

Në perandorinë **e pafundme**... (Emblema, 128);

Qyteti shtrihej **i pafund**. (Emblema, 80);

Nisën të rendnin përsëri përbri trenit me atë trokëllimë **të pambarim**... (Emblema, 43);

Turmat **e pafund** të ushtarëve... (Kështjella, 61);

Mbi të gjithë fushën **e pamatë**... (Gjenerali, 49);

Ai vështroi djerrinën **e paanë**. (Ura, 182);

Për të mbrojtur sytë nga kjo dritë **pambarim**... (Ura, 146);

Aksham mbi shtetin më **të hapsirshëm** të botës... (Ura, 440);

Ka një dhimbje **universale**. (Ura, 376);

Vështrova atë hapësirë **të pafundme**. (Ura, 385);

Moria **e pafundme** e ëndrrave... (Ura, 263);

Ai u gjend në një fushë **të pafundme**. (Ura, 263);

Me një gjerësi **të pafundme**... (Dimri, 335);

Gjithçka ishte **e stërmadhe**. (Dimri, 284)

Edhe tipari që lidhet me kohëzgjatjen mdodh që të paraqitet i ekzagjeruar. Fjala që e shënon këtë tipar zgjidhet e tillë që të shënojë një zgjatje të madhe kohe dhe qëndrime të ndryshme subjektive, si: lodhje, distancim shpirtëror, monotoni etj., të shkaktuara nga një rrjedhje e zgjatur e kohës. Psh.:

I qe zvjerdhur prej kohësh ajo gërgamë **e pafundme**. (Dimri, 295);

Kishte një ndryshk **shekullor**, një apati **primitive** në gjithë qenien e tyre. (Dimri, 565);

Një shakullinë **e pafund** ere.. (Dimri, 604);

Në bisedat **e pafundme** të njerëzve shfaqej ideja...(Ura, 55);

Qëndronin për të bërë sehir ardhjen e fqinjëve të tyre **shekullorë** ... (Ura, 223);

Nuk ia kisha treguar asaj, por letonezes nga Riga, në një verë **të stërlargët**, 100 vjet më parë. (Ura, 507)

Qyteti **i stërlashtë** ...(Kronikë, 82)

Rrethimet **e pafundme** ...(Emblema, 39)

Nisën të rendnin përbri trenit me atë trokëllimë **të pambarim** patkonjsh. (Emblema, 70)

Atë epos vigan **të stërlashtë** ...(Emblema, 404)

Kjo kërkesë e tyre **shekullore** (Emblema, 343)

Sinonimet, që mund të përdroreshin në vend të fjalëve të nënvizuara (përkatësisht: **i vjetër, i gjatë, e vjetër, e gjatë, të vjetër, të largët, i lashtë, e herëpashershme, të zgjatur, të lashtë, e vjetër**), nuk do të kishin forcën shprehëse e ndikuese të fjalëve të mësipërme. Ato ndihen krejt të zbehta përpara fjalëve që zgjedh shkrimtari.

Në disa raste ngjyrimet emocionale që shpreh fjala janë aq të forta sa duket sikur fjalët janë zgjedhur, jo si njësi shënuese, por si njësi shprehëse:

Ndaj është e padurueshme **për të ulërirë**. (Koha, 190);

Ideja e ndarjes m'u duk **katastrofale**. (Koha, 35);

...Atë ngjyrë **ngjethëse** (Koha, 306);

Univers **i lemerishëm** ...(Koha, 306);

Frynte një erë **e akullt**. (Emblema, 70);

Po projekton një top **të përbindshëm**. (Kështjella, 214);

E ndiente veten **të këputur**. (Kështjella, 116);

Tani ne jemi **të tmerrshëm**. (Kronikë, 104);

Ç'është kjo punë **miserabël** që na kanë ngarkuar të bëjmë. (Gjenerali, 124);

Kjo etje për pakëz lotë paskësh qenë një etje e fshehur dhe **e tmerrshme**. (Ura, 465);

Unë i trembur, gati **i tmerruar**. (Ura, 382);

Dinte të gatuante gjellë **të mahnitshme**. (Ura, 313);

Ai kishte fuqinë **e tmerrshme** të mungesës së faktit. (Ura, 264);

Ai njeri **i acartë** që nuk i fliste kujt. (Ura, 70);

Vërvitej **helm e pikë** rreth barakës. (Ura, 54);

Ndriçimi **i akullt** i neonit... (Dimri, 165);

Pas asaj ere **të stuhishme**... (Dimri, 614);

Ndriçimi i mesditës, **i humnershëm** në bardhësinë e tij... (Dimri, 519);

Qe kthyer në fshat **helm e pikë**. (Dimri, 502);

Ai kishte marrë kodrat **e skëterrshme** të Zeelit. (Dimri, 47);

Përrjashta era **e acartë**...cijaste. (Dimri, 449);

Sytë **e akullt**... të Ulbrihtit... (Dimri, 444);

Ajo kthen sytë... krejt **e tmerruar**. (Dimri, 407);

Procesi i përçundnimit kishte qenë i ngadaltë, **i stërmundimshëm**. Kuja **e përbindshme**. (Dimri, 190);

Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë kishin mbetur krejtësisht **të acarta**. (Dimri, 175)

Për ta dhënë më të gjallë tiparin e veprimit a rrethanën, shpesh Kadareja u drejtohet njësive frazeologjike. P.sh.:

Qyteti i ndyrë, me lagështirën që i qe futur **gjer në palcë** ia kishte sjellë shpirtin në majë të hundës. (Koha, 141);

Kokë... s'do të ngrinin **kurrën e kurrës**. (Koha, 292);

Ndërron si **era me shi**. (Koha, 310);

U duk se **sa të hapësh e të mbyllësh sytë**, na harroi. (Koha, 325);

Ai u ftoh **gjer në palcë**. (Dimri, 405);

Ishte i fyer **për jetë të jetëve**. (Dimri, 502);

Të kam pritur gjithë pasditen. Të kam pritur **me shekuj**. (Dimri, 614);

Kishte ardhur **me një frymë** në shtëpinë e tyre. (Dimri, 99);

Do të vazhdonin **deri në fund të botës**. (Ura, 82);

Paqja do të mbretërojë në **jetë të jetëve**. (Dimri, 302);

Në **jetë të jetëve** ndalohet krijimi i pashallëqeve. (Ura, 348);

E ka bërë **për faqe të zezë**. (Ura, 368);

Kurse Pasternaku vetë me siguri flet **zi e më zi** për Stalinin. (Ura, 474);

Ia kisha dhënë fjalën qysh në verën e shkuar, bile dhe më parë akoma, **qysh para një mijë vjetësh**. (Ura, 509);

Do të vazhdojë të konsiderohet si e tillë, **gjer në ditën e kiametit**. (Ura, 185);

Dasma do të bëhen gjithmonë, **gjer në ditë të kiametit**. (Kronikë, 150);

Ftohtë e kallkan, tamam **prapa diellit**. (Emblema, 175)

Po të krahasohen njësitë e nënvizuar me sinonimet e tyre, zëvendësueset e mundshme, bie në sy se njësitë e zgjedhura janë disa herë më shprehëse e sugjestionuese se barazvlerat përgjegjëse kuptimore, që përdorimi i përhershëm e i zakonshëm ua ka fshirë ngjyrimet shprehëse. Le t'i krahasojmë:

gjer në palcë- thellë; **kurrën e kurrës**- asnjëherë; **si era me shi**- shpejt; **sa të hapësh e të mbyllësh sytë**- menjëherë; **në jetë të jetëve**- gjithmonë; **me një frymë**- shpejt; **gjer në fund të botës**- gjatë; **për faqe të zezë**- keq; **qysh para një mijë vjetësh**- shumë kohë më parë; **gjer në ditën e kiametit**- gjithmonë; **prapa diellit**- shumë larg.

Shprehësia mund të fshihet dhe në fjalët që shprehin veprime a gjendje. Të gjendura me aftësi të zakonshme transmetuese, në ligjërimin afektiv ato mënjanohen e zëvendësohen me sinonime shprehëse e përshtypjelëse. Kjo gjë vihet re në shembujt më poshtë:

Po na dole përpara **do të të grijmë** (vrasim). (Koha, 308);

Zinxhir tanku, **kishte klithur** (thirrur) ajo me vete. (Koha, 215);

Dhe vetëm ideja... ishte mjaft që të **të dërrmonte** (lodhte). (Koha, 271);

Tha Besniku dhe **shkuli fijet** (hoqi). (Dimri, 192);

Ajo ikje fshehurazi, **ulëriu** (thirri) me vete... (Dimri, 516)
 Ai i **vërviti** mbi fytyrë pjatën me mjaltë (i hodhi). (Ura, 15);
 Kronikani **shqeu sytë** (hapi sytë). (Kështjella, 111)
 Si ekuivalente shprehëse përdoren dhe njësitë frazeologjike:
 Neve na **ngriu gjaku**. (Koha, 312);
 Ne të gjithë ishim **bërë baltë** në fytyrë. (Dimri, 134)(prishur);
Shqyheshin gazit me dhëndrrin turk. (Ura, 45) (qeshnin);
 Të gjithë si të dalldisur i **ngulnin sytë** kamares. (Ura, 129) (shikonin);
 Një natë krisi e **mori dhenë**. (Kronikë, 214) (iku)
 Një mundësi tjetër është përdorimi i një neologjizmi si ekuivalent shprehës:

Netët sa vinin **akulloheshin**. (Kronikë, 214) (ftoheshin);
 E **humneronte** pa shpresë (e gërryente). (Koha, 322);
 Shiu i imët i **akullonte** veshët (ftohte). (Ura, 59)
 Ka raste, ku si njësi shprehëse paraqiten turqizmat, të cilat bien në sy më tepër nga përgjegjëset kuptimore shqipe:

Na, prano baba, mos na **sikteris** (dëbo) (Koha, 342)
 Edhe në zgjedhjen e fjalëve që shënojnë objekte e dukuri vihet re kujdesi për të siguruar një shprehësi të spikatur. Në ligjërime hidhen njësi me vëllim informacioni e afeksioni sa më të madh. Sigurisht, njësi të tilla nuk takohen në çdo hap, por ato paraqiten atje ku ligjërimi rrezikon të çngjyroset nga përdorimi i vazhdueshëm i njësive të fshira e të harxhuara kuptimisht, ose atje ku kërkohet intensifikimi, zmadhimi i mendimit etj. P.sh.:

Vështrimi i tij kishte po atë **shkatërrim** (shpërqendrim) të ditëve të para të prillit. (Koha, 219)

Duart iu zgjatën në **terr** (errësirë). (Koha, 247)
 I munduar nga një frikë, gati **panik...** (Dimri, 18)
 Dukej sikur ishin **zgavrim** i përbashkët i një farë lodhjeje, përbuzjeje dhe pikëllimi gjysmë shekullor. (Dimri, 150)

Fanarët e Zimave të zinj që shuheshin e ndizeshin... në atë **terr** stepash (Dimri, 385)

Të dënonte të zotin e hotelit ku ai kishte pësuar atë **mynxyrë...** (Ura, 324)

Në qoftë se ata dalin të gjallë nga kjo **skëterrë**, atëherë vështirë të vdesin më. (Kështjella, 210)

Përpara **rrokopujës** (rrëmujës) së dërrasave ...(Emblema, 62)

II

Veç fjalëve shprehëse njëloj harxhimi kuptimor pesojnë dhe një grup fjalësh që përdoren shumë dendur në ligjërime. Të tilla janë fjalët: **jo, po, tha**. Nga përdorimi shumë i madh këto fjalë kanë humbur diçka nga pesha kuptimore. Psh. mohimi i bërë me fjalën **jo** le vend për t'u plotësuar me ndonjë fjalë tjetër që të marrë pamjen e prerë të një mohimi të mirëfilltë e

të padyshimtë. Fjala **jo** mund të përsëritet, mund të përforcohet nga fjalë të tjera me kuptim mohues si **aspak**, **kurrë**, **asnjëherë** etj.

Kadareja shpesh herë, në vend të „jo“-së mohuese, përdor fjalën **aspak** ose ndonjë mjet tjetër. Fjala **aspak** del e vetme, ose rrallë herë shoqëron fjalën **jo**. Mohimi i formuluar kështu është i prerë, kategorik. P.sh.:

Unë zoti mësues, unë **aspak**... (Koha, 18)

Është e njëjta gjë. **Aspak**. (Koha, 180)

- Jo, **aspak** - tha Sara. (Koha, 304)

- Më duket se të erdhi keq? - **Aspak**. (Dimri, 46)

- Nuk u mërzitët herën tjetër? - **Aspak**. (Ura, 500)

Fjala **aspak** ka ngjyrim libror dhe përdoret, kryesisht, nga persona e në mjedise intelektuale. E shoqëruar nga një fjalë tjetër mohuese kjo fjalë shpreh një mohim të theksuar.

- Nuk tallem **aspak**. (Dimri, 115)

- Jo, **aspak**, - tha Ana. (Emblema, 193)

- Jo-, i thshë mekanikisht, - **aspak**. (Emblema, 93)

Mohimi i bërë me fjalë të tjera me kuptim mohues paraqet dhe ngjyime të tjera kuptimore, emocionale. P.sh.: Dashurinë shkel e shko të një tjetri mund ta pranonte ajo, por tënden **kurrësesi**.

Fjala **kurrësesi** shpreh mohim absolut dhe vendosmëri në mohim.

Për të mohuar përdoret edhe fjala turke **mezallah**. Me anë të kësaj fjale bëhet një mohim i përfurcuar. Njëkohësisht fjala evokon mjedisin shoqëror, kulturor të personit që e përdor. Është fjala për një turkofil e mysliman fanatik:

Po Haxhi Dervishi tha: **mezallah**, me atë hararet të keq që ai ka... (Koha, 342)

Pohimi bëhet me fjalën **po**, por shpesh herë kjo lihet mënjanë dhe për të pohuar përdoren fjalë e shprehje të tjera, si: **natyrisht**, **sigurisht**, **patjetër**, **me gjithë qejf** etj., të cilat japin një pohim ekspresiv. P.sh.:

- Ka më? - **Sigurisht**, - tha gjeometri. (Koha, 85)

- Do të m'i lexosh? - **Patjetër**. (Koha, 234);

- Sektorë s'duhet të tregohemi... **Natyrisht**, **natyrisht**. (Koha, 65);

- **Sigurisht**- ia bëri ajo. (Ura, 432);

- Do të marrësh një kafe? - **Me gjithë qejf**. (Dimri, 231);

- Në qoftë se vërtet ka ndonjë gjë... - **Natyrisht**. (Dimri, 284);

- Të jetë vallë e vërtetë? - **Me siguri**. (Dimri, 521);

- A ka ndonjë vend? - **Po si s'ka**. (Emblema, 6);

- A shkojmë ndonjë ditë bashkë? - **Me gjithë qejf**. (Emblema, 200);

- Një alibi a mund të hidhet poshtë? - **Natyrisht**. (Emblema, 251);

- Do të më presësh? - **Patjetër**, Ana! (Emblema, 94);

Shprehësia e fjalëve pohuese të nënvizuara qëndron në vëllimin e tyre

kuptimor-emocional që është më i madh nga ai i fjalës **po**. Fjalët pohuese: **sigurisht, natyrisht, me siguri** evokojnë, gjithashtu ligjëimin libror.

III

Në replikat e në ligjëratën e zhdrejtë, atje ku mund të dilte fjala **tha**, del shpesh fjala **ia bëri** (barazvlerë kuptimore e fjalës **tha**).

- A thua - **ia bëri** konsulli... (Koha, 333);
- Ah, pa shiko, **ia bëri** vajza. (Koha, 237);
- Ah, sa mirë! – **ia bëri** ajo. (Dimri, 15);
- O, **ia bëri** befas Zana. (Dimri, 19);
- O- **ia bëri** dikush (Dimri, 25)
- Ashtu?- **ia bëri** tjetri. (Dimri, 460)
- Ç'kam kështu?- **ia bëri** ajo. (Dimri, 584)
- Ai **ia bëri** : -Ah, ju kuptova. (Emblema, 39)

Fjala **ia bëri** me kuptimin „tha“ është dukuri e gjuhës bisedore. Folja „bëj“ është nga ato folje të fondit themelor që krijon polisemi në rrethanat e ligjërmimit bisedor.

Siç ve në dukje Xh.Lloshi në „Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe“ kjo fjalë krijon polisemi të gjerë në ligjërimin bisedor. Kadareja e përdor këtë të dhënë gjuhësore jo vetëm në situata bisedash të përditshme, të zakonshme, por edhe në çaste zyrtare e në raste mbledhjesh të nivelit të lartë (psh. në përshkrimin e mbledhjes së Moskës):

- Eh, **ia bëri** Hrushovi. (Dimri, 170)

IV

Konsumimi semantik, në disa fjalë, ndodh për arsye shoqërore. Në emër të një etikete të përgjithshme synohet që fjalët me përmbajtje të rëndë, jepen me njësi gjuhësore që shprehin nocione në mënyrë më të zbutur. P.sh.:

E **pa bukur**, tha me vete me një lloj nervozizmi (e shëmtuar) (Koha, 47);

Ata kishin vite që **treteshin nën dhe** (kishin vdekur) (Koha, 291);

Ashtu si ca gra **të pabukura** që kanë tërheqje, të fshehtë (të shëmtuara) (Ura, 350);

Ajo tregonte një **mosdashuri** ndaj shkrimtarëve (indiferencë) (Ura, 397);

Arti është pranë tij dhe në **gjumin e përjteshëm** (vdekje) (Ura, 415);

Morën Isanë (e arrestuan) (Kronikë, 190)

Njëra pas tjetrës e **lanë këtë botë** (vdiqën) hallat plaka të Basriut (Emblema, 164)

Për tri ditë **iku nga kjo botë** (vdiq) (Emblema, 170)⁷

7 Në raste të tilla më tepër se harxhimi semantik kemi një lloj ndalimi për shkak të përmbajtjes së rëndë të fjalës. Njësia zëvendësuese është një lloj eufemizmi me anë të

Për të shmangur konsumimin semantik shkrimtari përdor mjete leksikore sa më shprehëse e ndikuese, gjithmonë në funksion të paraqitjes sa më të bukur të materialit letrar e të komunikimit sa më të mirë e sugjestionues me lexuesin.

V

Shenjë simbolike- (vice versa) shenjë ikonike

Një mënyrë tjetër e vënies në lëvizje të mekanizmit të konsumimit semantik është dhe shfrytëzimi i funksionit ikastik të shenjës gjuhësore. Është fjala këtu dhe për një zhvillim e përdorim të mëtejshëm nga ana jonë e teorisë së prezantuar nga E. Coseriu mbi funksionin ikastik të shenjës gjuhësore ose mbi relacionet midis shenjave dhe objekteve.

Në një kapitull të tërë të veprës së tij „Textlinguistik“ Coseriu merret me një funksion të veçantë të shenjës gjuhësore. Që në fillim të kapitullit ai thotë:

“Tani t’i drejtohem një lloj relacioni, që mund të jetë tepër i rëndësishëm për ndërtimin e kuptimit të tekstit, por, që linguistika moderne i ka kushtuar një vëmendje minimale. Është fjala për funksionin ikastik të shenjës, për imitimin direkt të objektit të shënuar me anë të shenjuesit të një shenje të vetme ose të shenjuesve të një varg shenjash; së fundi është fjala për relacionin midis shenjave materiale, bartësve shenjorë dhe objekteve të shenjuara.”⁸

Coseriu e analizon dukurinë në disa aspekte. Së pari përqëndrohet në planin e shprehjes, në substancën e shprehjes. Fillon me përshkrimin e imitimit me anë të onomatopeve. Gjuha me natyrën e saj tingëllore është në gjendje të imitojë zërat dhe zhurmat e natyrës. Por, vëren Coseriu, edhe në rastin e tingëllimitimeve nuk kemi ngjashmëri absolute. Edhe në këtë rast tipik për imitimin e botës me anë të tingujve gjuhësorë, ligji i arbitraritetit të shenjës nuk thyhet krejt. Coseriu dhe autorë të tjerë, që janë marrë me këtë çështje, bëjnë fjalë për realizimin e një ngjashmërie relative. Kështu, funksioni ikastik i shenjës do vështruar në të shumtën e rasteve si dukuri relative.

Për Coseriu konteksti luan një rol të rëndësishëm në manifestimin e ikonicitetit të shenjave gjuhësore. Ndodh shumë shpesh, thotë ai, që një shenjë nuk ka asnjë funksion ikastik në gjuhë, por në tekst e fiton një të tillë. Këtë mendim e ilustron me një varg të poetit latin Ennius:

At tuba terribli sonitu tarantatara dixit (Ennius, Annalen, 140)

Përkthimi pak a shumë është ky: Dhe një trumpetë me zë të frikshëm bënte tatarata.

Në këtë varg ikastike është vetëm fjala tarantatara si imitim i tingujve që

së cilës përmbajtja jepet e zbutur.

8 E. COSERIU, *Textlinguistik*, Tübingen, 1994, f. 111.

nxjerr trumpeta. Fjala tuba (trumpetë) është në një farë mënyre në gjuhë fjalë onomatopeike. Në vargun e Ennius të gjitha fjalët mbartin, shprehin diçka imituese. Kjo realizohet me anë të aliteracionit, me anë të përsëritjes së t – së në çdo fjalë të vargut, madje dhe në lidhëzën at (por). I gjithë vargu është ikastik.

Coseriu jep dhe shembuj të tjerë, ku fjalët nuk kanë në vetevete forcë, veçori ikastike, por e fitojnë atë në tekst. Ai citon p.sh. një varg të një poeti kroat (Nazor). Unë po jap këtu përkthimin gjermanisht për ta përkthyer pastaj në shqip:

und (es) zirpt, zirpt (die) Zikade, auf (der) Verzweigung der schwarzen Pinie

(dhe këndon, këndon gjinkalla në degën e pishës së zezë...)

Në vargun e cituar asnjë element nuk është direkt ikastik. Edhe fjalët me origjinë onomatopeike (zirpen, Zikade) janë gramatikalizuar dhe kanë humbur diçka nga funksioni ikastik. Ndërsa fjalët e tjera nuk janë as direkt, as indirekt ikastike. Por në këtë varg, për shkak të substancës fonike, ato evokojnë këngën e gjinkallës. Kështu, shenjat gjuhësore mund të mos jenë ikastike, por bëhen të tilla në tekst.

Këtë tezë të Coseriu, mbi funksionin ikastik të fituar brenda tekstit, e kemi shfrytëzuar shpesh në argumentimet e në analizat tona. Në funksionin imitues të prodhuar në tekst, zakonisht, marrin pjesë vargje shenjash dhe jo një shenjë e vetme. Kështu, në vargun e sipërcituar nga Ennius lidhëza at (dhe, por) nuk do të kishte asnjë funksion ikastik, nëse vargu nuk do të përmbante fjalë të tjera që kanë të gjitha në përbërje tingullin **t**.

I. Kadareja i përdor rëndom onomatopetë, aliteracionin, pasthirrmat, prozopopenë në funksion të gjallërimittë ligjërimit artistik, duke anashkaluar dhe shpërfillur një mënyrë analoge rrëfimi me elemente të përdorimit të gjerë e të zakonshëm. Kështu, hera-herës, shmanget komunikimi me shenja simbolike dhe fragmente thëniesh realizohen me shenja ikonike të cilat imitojnë (ose evokojnë) natyrshëm realie të ndryshme:

Ju iku babai, ju la të gjithëve, **ha, ha, ha** (Darka e gabuar, f. 196)

Të gjitha dëshmitë e jepnin **bla-bla**-në e tij. (Darka e gabuar, f. 200).

Nuk do të ndalemi gjatë në këtë procedë të tingullimitimeve (e cila është më aktive në stilin poetik të I. Kadaresë), por do të kalojmë në një përftesë tjetër kadareane me të cilën autori nuk imiton, nuk evokon objekte dhe dukuri të botës së jashtme, por shpreh emocionet, botën e brendshme ndjenjësore në një mënyrë të veçantë, të vërtetë e ndikuese. Duket sikur energjia shpirtërore e emetuar në formë urimi a mallkimi është e njëjtë me shprehjen gjuhësore..... Një ndër mjetet më të mira për ta dhënë këtë është:

Optativi

Në gjuhën shqipe si dhe në disa gjuhë të tjera optativi është një mënyrë

më vete në sistemin foljor. Optativi, si mënyrë e irrealitetit, shpreh zakonisht: dëshira (optativi kupitiv); urdhra të zbutur (optativi normativ); mundësi (optativi potencial). Si në shumë gjuhë edhe në shqip përmbajtja, që jepet me optativ, mund të jepet dhe me folje në mënyrën lidhore, urdhërore ose me perifrazime ku bën pjesë një folje modale. Por këto alternativa ligjëruese nuk e kanë forcën emetuese dhe afektive të optativit. I. Kadare operon shpesh me forma të optativit. Bien në sy sidomos ato përdorime ku dëshirorja transmeton dhe shpreh mallkime, dëshira negative, ndalime (dëshirorja prohibitive). Ndërtime të tilla sjellin në ligjërime natyrshmërinë e të folmeve gojore (ku ato janë shumë aktive) dhe afeksionin tipik letrar-artistik të prodhuar nga një talent si ai i I. Kadaresë. Në monologun “Lutje mbretërore” (Tri këngë zie për Kosovën, Tiranë, 1998, f. 85-86) gërshetohen disa mënyra për shprehjen e dëshirave: forma të mënyrës dëshirore, forma të urdhërores dhe të lidhores:

Mallkuar qofshi, popuj të Ballkanit, ju që më detyruat **të marr** udhët në pleqëri, për të lënë kryet në këtë fushë. **Mallkuar qofshi** sidomos për këtë vetmi! (dëshirore), (f. 85)

...të lutem, **jepmë** më në fund harrimin...(urdhërore), (f. 87)

Bëj që ta heqin gjakun tim nga kjo fushë e ftohtë. (bëj + të heqin; perifrazim), (f. 88)

Mallkimet, që vijnë nga mosekzistenca, mallkimet e shpirtërave kanë fuqinë e pamasë të një goditjeje të papritur e të padukshme. Fizikanti nobelist, Max Planck, në një thënie proverbiale pranon gjithëfuqinë e shpirtit të zhveshur nga materia:

“Materia e përkohshme, që ne shohim rreth nesh, nuk është e vërtetë dhe reale. I vetmi realitet është shpirti i padukshëm dhe i pavdekshëm.” (M. Planck: *Vorträge, Reden, Erinnerungen*, Heidelberg, 2001, f. 132)

Një mallkim të ardhur nga sfera e shpirtërave formulon I. Kadareja në romanin e tij “Lulet e ftohta të marsit” (Tiranë, 2000, f. 147- 148):

“Atëherë klithma jonë, që është njëherësh lutje për mëshirë, vaj e mallkim, e mbush tejmbanë ujanën: **u mbyllç** kanali i Otrantos! **U thafsh**, e dielli të **zhurittë** e qerret me kripë e helm të **kalofshin** sipër jetë e mot!”

Formula të tilla, ku optativi shfaq fuqinë e tij si shprehje adekuatë, e natyrshme e afsheve shpirtërore, e shfrimit të dufit final, duken sikur sjellin njëlloj qetësimi në shpirtin e trazuar të atyre që u ndanë me lemeri nga kjo jetë. Format në lidhore e format e tjera të mundshme për raste të tilla nuk do ta kishin këtë mundësi e këtë forcë komunikative- shprehëse.

Letërsi artistike e shqyrtuar

1. Darka e gabuar, Tiranë, 2008.
2. E penguara, Tiranë, 2009.
3. Përballë pasqyrës së një gruaje, Tiranë, 2001.
4. Lulet e ftohta të marsit, Tiranë, 2000.
5. Mëngjeset në Kafe Rostand, Tiranë, 2014.
6. Ftesë në studio, Tiranë, 1990.
7. Vepra letrare 10, Tiranë 1981.
8. Kronikën në gur, Tiranë, 1978.
9. Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, 1980.
10. Emblema e dikurshme, Tiranë, 1981.
11. Ura me tri harqe, Tiranë, 1978.
12. Gjakftohtësia, Tiranë, 1980.
13. Dimri i madh, Tiranë, 1980.
14. Kështjella, Tiranë, 1973.

Letërsi teorike e konsultuar

1. A. Xhuvani, E.Çabej: *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1964.
2. A. Kostallari: *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve, Tiranë, 1972.
3. A. Kostallari: *Kompozitat të shirore dhe urdhërore të shqipes*, Studime Filologjike, Tiranë, 1968,4.
4. A. Kostallari: *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Nëntori, Tiranë, 1965.
5. A.Vehbiu: *Fjalët e huaja, neologjizmat dhe ligjërimi*, Gjuha jone, Tiranë, 1986, 1.
6. A. Angoni: *Pjesëzat në gjuhën shqipe*, SF, Tiranë, 1971,3.
7. E. Coseriu: *Textlinguistik*, Tübingen, 1994.
8. F. Beja: *Përçimi i stilemeve nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas*, Gjuha jonë, Tiranë, 1986, 1.
9. G. Hadaj: *Shembull analize teksti*, Revista pedagogjike, Tiranë, 3.
10. J.Thomai: *Krijimtaria gjuhësore e shkrimtarit, shprehje e prirjeve të tij ideore e stilistike*, Drita, 25.1.1987.
11. J. Thomai: *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.
12. J. Kole: *Pjesëzat si kategori leksiko- semantike në shqipen e sotme*, Tiranë, SF, 1969, 3.
13. K. Cipo: *Gramatika e gjuhës shqipe*, Elbasan, 2015.
14. L. Buxheli: *Emrat e veprimt me prapashtesat – im dhe –je në gjuhën letrare shqipe*, Tiranë, SF, 1981,4.

15. L. Blumfeld: *Jazik*, Moskë, 1966.
16. M. Domi: *Mendime dhe vërejtje për gjuhën në prozën tonë artistike*, "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës", Tiranë, 1973,1.
17. M.Ymeri: *Vëzhgime për gjuhën e prozës artistike*, Gjuha jonë, 1982, 2.
18. M. Çeliku: *Disa togje foljore në shqipen e sotme*, Buletin i USHT, 1963,1.
19. M. Breal, *Essai de semantique*, Paris, 1897.
21. R. Jakobson: *Essais de linguistique generale*, Paris, 1963.
22. S. Prifti: *Sintaksa e gjuhës shqipe*, 1959.
23. Sh. Demiraj: *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, I,II, Tiranë, 1960.
24. Xh. Lloshi: *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987.
25. Xh. Lloshi: *Shkrimtari dhe gjuha*, "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës", Tiranë, 1973 ".
26. Xh. Lloshi: *Mbi studimin e veçorive stilistike të shqipes*" SF. 1970, 1.
27. Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe ,1984.
28. Gramatika e Gjuhës Shqipe, I, II, 2002.
29. Leksikologjia e gjuhës frënge , Lausanne, 1981.